

Procesverbal

Nga Mbledhja V (e pestë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 27.05.2024

Rend Dite

- 1) **Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën V; dhe**
- 2) **Eventuale.**

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar! Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen V të rregullt të KPF-së për vitin 2024! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Para se me e qit në votim, a ka dikush me shtue diçka ose me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Veç deshta me e pyet kryesuesen, edhe kryetarin, a kemi ndonjë pikë të rendit të ditës shtesë sot, për nesër, a ndonjë pikë me e hek, a qysh janë sendet?

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë rendin e ditës.

Munir Jonuzi: Kam dëgjuar në përkthim që thatë: me tre vota pro, dy kundër dhe një abstenim. A është përkthyer. Ne rregull.

Arijeta Skeraj: Atëherë, vazhdojmë me pikën e parë të materialit të seancës: Miratimi i Statutit të QKMF-së.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së, përfaqësues i OSBE-së, përfaqësues të tjerë të Komunës, ju përshëndes! Këtij Komiteti i dëshiroj punë të mbarë! Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, siç e dini, Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar nga të gjitha QKMF-të e Kosovës që të bëjnë aprovimin e statutit, duke u bazuar në Ligjin e shëndetësisë. Shumica prej komunave të Kosovës këtë e kanë bërë këtë, edhe QKMF-ja e Komunës së Dragashit e ka përgatit Statutin. Por, dua të ju njoftoj se është i njëjti statut, siç ka qenë edhe më herët, nuk ka ndryshime, për arsye se edhe herën e kaluar ky statut është përgatit në bazë të Ligjit për shëndetësi. Në bazë të këtij Statuti, ne si Komunë i kemi disa lehtësina, ku neve na është lejue edhe pozita e gjinekologut edhe pozita e pediatrit. Arsyeja është se të gjitha ato komuna të cilat deri më tani e kanë pasur lindoren, atëherë këtyre komunave u lejohet në të ardhmen që t'i kenë edhe këto dy specializime. Kështu që, ky statut – ata të cilët janë asambleistë të ri – është statut i njëjtë. Unë dola këtu me e bo këtë arsyetim, se mundem si kryetar i Komunës me e bo arsyetimin. Drejtori i Shëndetësisë është në rrugëtim zyrtar për Prizren, drejtori i QKMF-së është në pushim. Kështu që, besoj që mjafton ky arsyetim i imi që e kam bërë për sot. Faleminderit!

Artan Loshaj: Shumë mirë kryetar, që dole edhe u deklarove, po nuk është arsyetim sot, kur është një statut i QKMF-së të votohet, drejtori i Shëndetësisë të mos jetë prezent, si dhe drejtori i QKMF-së, ushtruesi i detyrës. Unë edhe në fillim të kam thënë, e i kam thënë edhe z.Shabanit, që dështimi më i madh i kësaj Komunë është që Behar Brenoli, një mësues, të jetë këshilltar politik i Shëndetësisë, për atë është edhe shëndetësia ku është, në kolaps e sipër. Drejtori i Shëndetësisë nuk di dy fjalë me i folë këtu, se s'di, është i paaftë për me e udhëheq shëndetësinë. Atë e keni bo

si 'kumth', njëfarë prerës i shiritave në urbanizëm, është t'u u marrë ai non-stop, me siguri është kah stadioni atje, s'është në Prizren në udhëtim zyrtar. Se unë kam dëshmi këtu që, në vend se të jetë drejtori i Urbanizmit prezent – po të falënderoj për stadionin në emër të krejt qytetarëve edhe sportistave – në vend se të jetë prezent drejtori i Urbanizmit aty, është prezent drejtori i Shëndetësisë. Tjetër, kam foto këtu që merret me parkun e e QKMF-së, i vë do ndalesa aty, e merr me do burmashina, me do sende. Të kam thënë, kryetar, prej fillimit – se nesër po kam qef ai të jetë prezent – dështimi më i madh i kësaj qeverisjeje është që Behar Brenoli e udhëheq shëndetësinë.

Bexhet Xheladini: Drejtori i Shëndetësisë ka qenë edhe në qeverisjen e kaluar. Ti e dish qysh shkojnë koalicionet, partia VAKAT-VATAN e ka dhënë emrin, edhe normal unë e kam miratue atë si drejtor i Shëndetësisë. Sot është në udhëtim zyrtar, edhe kryetari i Komunës ka të drejtë me e zëvendësue secilin drejtor, me dhënë arsyetim. Ti këtë e dish, se je asambleist me shumë përvojë. Atë ditë që e përmendet, ne kemi qenë të ftuar zyrtarisht në përrurimin e fillimit të punimeve të një xhamie në fshatin Leshtan. Ndërkohë, Sabahat Hasani na ka thirrë që ka fillue shtruarja e tepihut, edhe ne prej asaj ceremonie kemi shkue drejt e atje. Kështu që, s'është gabim nëse ai ka ndodhë aty. Ndërsa, sa i përket asaj që po bën punime në QKMF, normal ai merret edhe me punë tjera, i shkon dorës, kështu që nuk është gabim që ai bën ndonjë punë të mirë në shëndetësi. Kjo nuk është e ndalume, se atë e bën pa pagesë edhe në mënyrë vullnetare.

Artan Loshaj: Kryetar, mos e merr shumë personale, të thashë, se e udhëheqish Komunën ti. Unë edhe Shaban Shabanit, si delegat i PDK-së, i kam thënë se dështimi më i madh është një mësues, një mjeshtër i kockave, që vë kocka e që merret me ato, me u bo drejtor i Shëndetësisë. Të kam thënë edhe në fillim këtu, me iu bo Shaban Shabanit këshilltar, është një biology, s'është problem. Me iu bo mjekut specialist 40-vjeçar, me iu bo një mësues këshilltar, s'po ma kap bre. Edhe është mirë – ke kohë – është mirë me botë Urbanizmit se i shkon, nime për dore i shkon atij, se vë kocka edhe i shkon për dore me e ndërrue me Beanin. Beani kishte qenë më mirë me qenë drejtor i Shëndetësisë, se është jurist, bare e kap ndonjë ligj, ndonjë send e di. Ky as macë e as mi, s'po di. Ndërro një troh, kie mundësi me i ndërrue. Atë bone të shëndetësisë, se e kie jurist, këtë bone se vë kocka, edhe shumë mirë po i vë, me e pa çfarë parkinku ka bo, me të met sytë aty. Jo bre, perfekt e ka bo, s'thashë kurgjo unë, e ka bo, se punimet i ka bo ma mirë se Sabahati e këta që po i bojnë, tenderat që po i marrin. Domethënë e kie një punëtor të zellshëm, veç për drejtor të Shëndetësië s'e kie. Për çka të duash mundesh me vu, drejtor të Shëndetësisë e ke marrë veten në qaf, kryetar. Edhe qetu e keni pas shëndetësinë pikë të dobët kur e keni marrë pushtetin, qeky Behari ka me ta hup pushtetin edhe kemi me ta marrë kismet në 2025-tën.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? A ka abstenim? Me 2 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet.

Artan Loshaj: Më fal znj. Kryesues, jemi pesë veta në seancë, me dy veta pro, s'besoj që kalon kjo. Ama pesë veta jemi në sallë. Okej, mirë, po pyes. Më fal! S'po i di rendet, kam ardhë me u mësue këtu.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Atëherë kalojmë te pika e dytë: Miratim i Planit të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026.

Zeni Krasniqi: I nderuar kryetar i Komunës, z.Bexhet Xheladini! E nderuar kryesuese, ju të dashur anëtarë të Komitetit! Si Drejtori e Arsimit, kemi punue në këtë drejtim, që të marrim një vendim për themelimin e Ekipit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës. Në mbështetje të Nenit 3 dhe Nenit 5, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.4., Paragrafi 16, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në RKS, Neni 6, Pika 1 të UA të MASHTI-t Nr.08/2018, për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, DKA-ja ka marrë vendim për formimin e Ekipit për Parandalimin dhe Reagimin Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar. Ekipi është formue në një përbërje prej 9 anëtarëve, detyrat e ekipit janë përcaktuar me Nenin 6 të UA 08/2018 të datës 25.05.2018. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Ekipit dhe DKA-ja. Ekipi ka punue në bashkëpunim me UNICEF-in, Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve, si dhe DKA-në. Ky Plan ka kalue të gjitha fazat e dëgjimit publik dhe është përcjellë për miratim në Kuvendin e Komunës. Ju këtë Plan të Veprimit e keni përpara, me siguri e keni lexue edhe cili është qëllimi. Është koordinimi i veprimeve ndërinstucionale, dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal në zbatimin e detyrimeve ligjore për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes. Objektivat janë më gjerësisht të paraqitura edhe në formë tabelare. Objektiva e përgjithshme është parandalimi dhe identifikimi i hershëm i nxënësve me rrezik të braktisjes, si dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata. Objektivat specifike ju me siguri i keni lexue, i keni para jush atje, nuk ka nevojë t'i përsëritim. Prandaj, kërkesa e DKA-së është, bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe ECMI-në, që ju në Kuvend ta votoni këtë Plan. Ju faleminderit!

Artan Loshaj: z.Drejtor, po due me e bo një pyetje, se s'po mundi me e kuptue. Parandalimi i braktisjes – s'po e kuptoj – a fëmijët që nuk regjistrohen hiç, apo fëmijët që regjistrohen në Prizren. Qysh do të vjen puna deri aty, shumë seriozisht po të pyes. Edhe a ka mundësi, masi je drejtor, me më kallxue për shembull, këtë vit që shkoi sa fëmijë nuk janë regjistruar, sa fëmijë ka pas të klasave të 9-ta në nivel komunal nëpër shkolla fillore, edhe në Gjimnaz sa kanë arrit? Për shembull, në qoftë se ka pas shkolla e Blaçit, Bresanë, ku ka shkollë të mesme, Kosavë, Bellobrad, Brezne, në Gorë për shembull, në qoftë se komplet klasët e 9-ta kanë qenë 300 nxënës, më 1 shtator sa të kanë ardhë në Shkollën e Mesme të Lartë “Ruzhdi Berisha”. Për shembull, ky vit që po shkon sa fëmijë kanë qenë në klasët e nënta edhe sa fëmijë janë regjistruar në shkollë të mesme, po due me e bo njëfarë statistike, sa na janë largue për Prizren. Pak më hollësisht me na shpjegue qysh sivjet do t'i stimuloni, për shembull, më 1 shtator – djali jem sot e kryen shkollën, më 1 shtator shkon në Prizren. Qysh, me çfarë kushte, me çfarë mundësi – di që keni me thënë vozitja pa pare, po ndonjë drejtim pak më atraktiv që është për shembull. Se unë e kam djalin në klasë të nëntë, po pyes si prind sot, që më 1 shtator djali jem më ka thënë po due me shkue në Prizren, se s'kam ku me shkue këtu. Po mirë, ai po do me shkue me u bo kamarier, për shembull. Po mirë de, ai po do qashtu, se

të drejtat e fëmijëve ne po thona janë të barabarta. Po due me e ditë qysh keni me i josh këta fëmijët, a keni ndonjë drejtim të ri apo qysh keni me i ndalë, se unë djalim tem s'un po e ndali.

Munir Jonuzi: I nderuar Zotëri/Zonjë, po ju drejtohem në lidhje me planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë, por para kësaj do të komentoj pak pjesën e mëparshme mes presidentit dhe një kolegu të deleguar në lidhje me drejtorin e shëndetësisë. Zoti President ka të drejtë të thërrasë në terren kë të dojë, kush mendon se duhet të jetë aty, megjithatë presidenti ka kabinetin e tij, ka shefin e tij të kabinetit, ne nuk mund të përcaktojmë për të kë do të marrë me vete. , por këtu është vetëm një shfaqje e forcës së drejtorit të shëndetësisë për të marrë pjesë në krijimin e investimeve kapitale, për të marrë pjesë në tenderë, për të marrë pjesë në ndërtim. Në këtë mënyrë po bëhet një lloj politizimi për të marrë sa më shumë vota në Gorë. Arsyeja e dytë, ndoshta për mendimin tim, ndoshta e kam gabim, është sepse drejtori i Kadastrës po përgatitet nesër të bëhet prokuror publik, ndaj nuk është shumë bukur ta shohësh në takime politike me përfaqësues politikë, sepse nuk është mirë të jetë drejtor i urbanizmit, apo shef i zyrës politike dhe tashmë nesër të jetë një prokuror publik që nuk duhet të merret me politikë. Prandaj, me siguri drejtori i shëndetësisë e zëvendëson drejtorin e urbanizmit. I kthehem kësaj pike të rendit të ditës, duke qenë se nuk kemi nënshkruar të këtij plani, derisa drejtori nuk na është drejtuar, nuk e kam ditur se kujt t'i drejtoj pyetje. Së pari, më intereson nëse është formuar një grup komunal kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë. Cilët anëtarë janë ata? A janë anëtarët në përputhje me udhëzimin administrativ. Më duket se është 20/8 apo 2017, nuk më kujtohet saktësisht, a i numëroni këta studentë të paregjistruar si dhe fëmijë që nuk vijnë sistemin e Kosovës. A keni të dhëna për numrin e studentëve të paregjistruar, pra të atyre që janë regjistruar në ndonjë sistem tjetër. Mendoj se duhet t'i kemi ato të dhëna, sepse ne si komunë paguajmë energjinë elektrike, ne si komunë paguajmë inventarin për shkollat, kështu që është koha të dimë dhe të kemi disa të dhëna. Këtu ju deklaruat se 5 nxënës të shkollës fillore Fetah Sylejmani dhe katër nxënës të gjimnazit Ruzhdi Berisha e kanë lënë shkollën, më intereson a e dini arsyen, sidomos për këta nxënës të shkollës fillore, këta pesë nxënës të shkollës fillore. Pse e lanë arsimin. Për të shpjeguar një situatë, nuk konsiderohet se dikush e ka lënë shkollën, pra shkollimin, nëse shkon në Prizren apo në ndonjë shkollë tjetër. Është një rast i rëndë që katër nxënësit tanë të shkollave fillore përfundojnë shkollimin. Nëse kanë shkuar në Prizren, sipas dekreteve dhe rregulloreve ligjore, nuk konsiderohen të larguar. Më intereson nëse ne si komunë, a mund t'i ndihmojë ky grup punues komunal, që ata fëmijë t'i kthejnë në shkollë. Më tej keni identifikuar 13 studentë me mundësi të kufizuara, më intereson nëse planifikojmë të krijojmë apo të ofrojmë dhoma për studentët me këto mundësi të kufizuara. E di që në të kaluarën ka pasur një iniciativë të tillë për të formuar disa klasa për nxënësit me mundësi të kufizuara dhe në atë mënyrë për t'i përmbushur ata. Pra, më intereson nëse diçka e tillë është planifikuar në të ardhmen, ndoshta po ndodh tashmë, por nuk e di. Objektivi dy, krijimi i kushteve për një kalim të lehtë, nga shkolla e mesme e ulët në atë të mesme të lartë, ndaj më intereson se si planifikoni t'i ndihmoni ata gjatë këtij tranzicioni. A e specifikoni krijimin e partneriteteve me bizneset lokale si synime specifike 2.3, më intereson se në cilat profile planifikoni ta zbatoni këtë. Dhe duke pasur parasysh që me këtë plan veprimi kemi siguruar 42.000 euro për transportin e nxënësve, më intereson edhe një nga propozimet e mia, duke qenë se po

investojmë kaq shumë për transport, shpresoj që nxënësit e asnjë fshati të mos diskriminohen.. Thjesht duhet të krijojmë kushte të barabarta për nxënësit. Si komunë kemi siguruar transport për të gjithë nxënësit, ndaj disa fshatra nuk duhet të diskriminohen, e disa të mos privilegjojen.

Zeni Krasniqi: Faleminderit për pyetjet! Unë do të mundohem t'ju përgjigjem në këtë drejtim për pyetjet e juaja. Mirëpo, më detajisht ka punue ekipi, dhe jo që unë nuk mundem me ju dhënë përgjigje, por ata konkretisht për secilën pikë që janë pararqit në këtë Planin e Veprimit mund edhe të ju japin, po unë do të mundohem të ju përgjigjem. Ne me emër e mbiemër nuk mundim me i ditë se sa nxënës kanë qenë, mirëpo ne gjithmonë e bëjmë planin, kërkojmë prej drejtorëve kur na kërkohet nga Ministria për planin e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë. Ne e kemi bërë vitin e kaluar, edhe këtë vit e kemi bërë, po për momentin unë nuk i kam këtu, i kemi në Drejtori. Sa nxënës janë planifikue, do të thotë prej krejt klasëve të nënta, edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën boshnjake. Por, këto munda unë nesër të jua sjell konkretisht, saktë numrin e nxënësve sa janë planifikue edhe sa do të vijnë. Për secilin nxënës, prej Blaçit që e more konkretisht për shembull, nëse janë 27, a kanë ardhë 25, ne për secilin veç e veç nuk mundim me e ditë, këto mundim me shkue me i nxjerrë prej drejtorit të Gjinnazit atje, me i marrë me emër e mbiemër se ky nxënës ka qenë në klasën e nëntë këtë vit edhe pse s'ka ardhë këtu. E vetmja mundësi që ka qenë ne si Komunë iu ndihmue, e kemi bërë atë, falë kryetarit, sigurimin e transportit. Tash, sa ka ndikue transporti, na nuk e kemi një barometër shumë të saktë, me ditë se ka ndikue. Normalisht se ka ndikue mirë, se ka ndikue drejtpërdrejt në xhepin e qytetarëve. Për shembull, ai që i ka dy fëmijë, ai e ka shumë më lehtë të bjer nxënësin pa pagesë në Gjinnaz, se ata që janë në Prizren. Plus tjerat janë edhe ato, ti e din, Komuna e Pizrenit ka vu disa kufizime në regjistrimin e nxënësve, sidomos në drejtimin e mjekësisë. Këtu kemi numër bile që e tejkalon numrin e paraparë, të kufizuar. Këto drejtime, sidomos të infermierisë, na edhe vitin e kaluar kemi pas, na janë kërkue 22, i jemi përmbajt dhe ka qenë decidiv edhe kryetari që mos të rritet ky numër. Neve na vjen keq për nxënësit, por thashë, forma e parë që neve iu kemi ndihmue qytetarëve në këtë drejtim ka qenë transporti, e për numrin thashë të tregoj nesër. A është formuar Ekipi për mosregjistrim? Ky ekip ekziston - edhe Muniri i përmendi veç – këtu e ke të shënuar, në Komunën tonë funksionale janë 36 objekte shkollore, 12 shkolla amë dhe 23 shkolla satelite, një shkollë e mesme e lartë. Për vitin shkollor 2023/2024 i kemi gjithsej 3041 nxënës – këtë e keni pas edhe në Raportin e DKA-së. Braktisës të shkollës për këtë vit janë gjithsej 9 nxënës, 5 janë të shkollës “Fetah Sylejmani” kurse 4 janë të Gjinnazit. Se për çka e kanë braktis, tash edhe është formue ky Ekipi edhe ai do të punojë detajisht, ju e keni në forma se cilat janë ato objektivat edhe kur do të mbahen trajnime. Do të mundohemi në atë drejtim, që për secilin rast të hulumtojmë. Ky Ekip do të japë edhe raport tremujor dhe gjashtëmujor. Ti pyete braktisja, ajo dihet çka është. Është regjistruar në klasën e nëntë ose në klasën e tetë, i ka dalë një rast që na nuk mundim me e ditë konkretisht se për çka ka ik, për shkaqe familjare ose ka emigrue jashtë, ose ka ndërrue qytetin prej Dragashit në Prizren ose në Fushë Kosovë. Këto janë statistikat që i kemi gjatë këtij viti shkollor. 13 nxënës janë me aftësi të kufizuara, 12 nxënës me vështirësi në të nxënë, 12 nxënës me mungesa të shumta, rrezik për braktisje janë 4 nxënës. Me ju thënë të drejtën ne kemi marrë pjesë, po ndoshta edhe dikush prej juve ka marrë pjesë nëpër këto trajnimet, numri i saktë nuk dihet, se hezitojnë prindërit që t'i

tregojnë fëmijët me nevoja të veçanta. Neve na vjen mirë, këtë vit e kemi parapa edhe veç ka fillue aksioni i kësaj vizitave sistematike nëpër shkolla. Është aty një plus i madh, përveç asaj, ata mjekë mund edhe ta zbulojnë ndonjë rast, megjithëse ne kemi edhe pedagog, kemi edhe koordinatortë cilësisë të cilët i përcjellin këto raste. Në njëfarë forme, ne kemi edhe shënime. Ne kemi nevojë për dy psikologë edhe e kemi parapa në këtë Plan që gjithsesi duhet ta kemi, nëse jo nëpër shkolla, duhet ta kemi në DKA së paku një psikolog që do të merret me këto raste. Për orientimin në karrierë, për fat të keq, ne kemi pas kërkesën që sipas konkursit ta emërojmë edhe një koordinatortë për orientim në karrierë, mirëpo edhe kjo nga Ministria na është refuzue, përveç kësaj, edhe tri pozita tjera. Kurse, sa i përket pyetjeve se a është formuar Ekipi për mosregjistrim, se di a e kam kuptue pyetjen mirë, Munir. Ky Ekipi, veç thashë, është formue, e ka përgatit Planin e Veprimit, draft-planin që do të kalojë nesër për votim. Ky Ekip do të merret konkretisht me të gjitha ato raste që i paraqite, ato shqetësimet dhe brengat jo vetëm tuajat, por të gjithë qytetarëve. A e përfshin edhe në drejtimin paralel, normalisht që ne jemi të interesuar dhe kemi shifra edhe te këto drejtimet, mirëpo ajo varet krejt prej drejtorëve të mësimit paralel. Ne i kemi për të gjitha, edhe në Restelicë, edhe në Krushevë edhe në Brod i kemi disa numra që na kanë ofrue, por numrin e saktë të tyre nxënësve e dinë vetëm ata. Shkaku i braktisjes së nxënësve nga Gjimnazi dhe shkolla “Fetah Sylejmani”, ju thashë edhe pak më herët që ne nuk mundim me e ditë konkretisht shkakun se pse e ka braktis ose nuk është regjistruë. Thashë, ose për shkaqe familjare, ekonomike, ose ka emigruë jashtë, e ka krejt familjen atje, është regjistruë edhe për momentin ka braktis shkollën. Edhe ka forma të tjera, por këto konkretisht thashë edhe ky Ekipi në të ardhmen do të merret me secilin rast veç e veç, se do të ketë edhe trajnime të ndryshme edhe ligjërata të ndryshme, me qytetarë dhe me të tjerë. Normalisht që Ekipi do të punojë, do të bëjmë çmos për me i kthye këta nxënës, mirëpo sa do të ia arrijnë qëllimit, ata do t’ ofrojnë këto mundësi që i kanë. Ne do të kërkojmë prej Komunës që të ndajmë një pjesë të mjeteve buxhetore për këtë Ekip, se kërkon një kosto, jo shumë të madhe, se e keni parë aty, janë diku 69 mijë euro për tri vite. Këto nevojiten vetëm për ata trajnuesit edhe për ato takimet e ndryshme ose trajnimet që do të mbahen gjatë këtyre tri viteve. Është fjala për tri vite, ndoshta nuk është ndonjë shumë e madhe, përkundër temës e cila diskutohet – është shumë shqetësuese edhe për ne, edhe për prindërit edhe për të gjithë – braktisja e shkollave tona. Duke e marrë parasysh edhe këtë trendin pas liberalizimit të vizave, kemi një trend të lëvizjeve shumë të mëdha. Për fat të mirë, të arsimtarëve nuk kemi shumë, por të nxënësve – une e kam dhënë një statistikë, se na kërkohet prej MAPL-së – për periudhën 1 janar 2024 deri më 31 mars 2024, kemi diku një shifër prej 45 nxënësve që janë largue prej shkollave. Tash, sa janë kthye, kemi përgatit edhe ato, kemi bërë kërkesë prej drejtorëve se sa nxënës kanë shkue, se ka prej tyre edhe që kanë shkue me i vizitue familjet për një dyjavore, njëmuajore etj. Ne i kemi përmend këto sipas të dhënave tona – Munir – nuk e dimë edhe shumë saktë, thashë, se prindërit hezitojnë, për fëmijën e vet secili heziton, për fat të keq ekziston ajo. E ka falë Zoti atë, edhe duhet prindi ta paraqet rastin se është me nevoja të veçanta dhe ai duhet të trajtohet. Ne kemi një shifër këtu, janë 13 nxënës. Më duket, sa të kuptova the që a keni ndarë ndonjë lokal edhe cilat janë mundësitë e Ekipit për ndihmë ndaj këtyre nxënësve. Thashë, unë vetë kam marrë pjesë, por edhe ekipe tjera kemi marrë pjesë, sidomos për braktisjen i kemi mbajt dy-tri takime vitin e kaluar me organizata

të ndryshme. Ne gjithsesi duhet t'i trajtojmë në një formë çfarë ata e meritojnë edhe, me siguri, ky Ekipi në të ardhmen konkretisht do të merret me këto raste, edhe do t'i trajtojë në atë formën e duhur. Edhe tha 42 mijë euro për transportin, thashë i kemi sigurue te transporti, megjithëse disa pika nuk kërkojnë, por është rasti për këto, për ndonjë trajtim të veçantë, për shembull, se e dini që konfiguracioni i terrenit te na është i shtrirë kështu, kemi për shembull relacionin Dragash – Restelicë diku 24 km. Ai kërkon edhe një kosto për transportin e këtyre rasteve, duhet me u marrë me to nëse ndodhin në shkollë edhe patjetër ky ekip do të shkojë edhe në Restelicë, edhe në Zaplluxhe, pavarësisht ku janë këto raste. Përndryshe, ky Ekip edhe e ka përgatit këtë Plan të Veprimit, në këtë plan i ka parapa këto, ju shumë mirë edhe i keni lexue, edhe në të ardhmen presim rezultate prej këtij Ekipi.

Artan Loshaj: Drejtor, qe ky Ekipi a është formue, edhe në qoftë se është formue nga kush është formue? E dyta, a ka mundësi ky Ekip nesër të na japë më shumë sqarime. Tre: Kush i kandarë këto mjete, ju apo i ndanë Kuvendi, këto 69,300 eurot? A paguhet ky Ekipi? Edhe më herët thajë se 22 nxënës janë në Infermieri, këtë s'po të akuzoj shumë, se keni qenë më të kujdesshëm sesa na të PDK-së, se na i kemi pas 22 e i kemi marrë 42, ju i keni 22 me i marrë, i keni 28. Kjo nuk është shifër e saktë, ti thaje 22, është 28 se këta fëmijët që janë në Infermieri vijnë te na bojnë praktikë, domethënë janë 28. Edhe këta dy psikologët, a i keni marrë, a keni me i marrë, edhe kur keni me i marrë, kur fillojnë punën, qysh fillojnë punën? Se Planin e keni 2024-2026, a 2024-shi shkoi. Mirë, në rregull, po qeta dy psikologë në qoftë se i keni është mirë me i ditë, në qoftë se s'i keni, kur keni me i marrë, a keni me hap ndonjë konkurs? Faleminderit!

Munir Jonuzi: Dëshiroj të falënderoj zotin Drejtor Arsimi që na dha përgjigje vërtet të detajuara, por mbase nuk dëgjova, ndoshta nuk folëm për kalsat për nxënës me nevoja të veçanta. Mendoj se kjo është një çështje shumë serioze me të cilën ne si komunë duhet të merremi. Sa i përket grupit që e ka formuar këtë plan veprimi, në bazë të udhëzimit administrativ, kemi se është një grup prej nëntë anëtarësh, përndryshe sa për të thënë udhëzimi administrativ është 8/2018, dy përfaqësues nga drejtoria komunale, një përfaqësues i këshilli i prindërve, një përfaqësues i mësimdhënësve, një përfaqësues i këshillit të nxënësve, drejtori i shkollës, një përfaqësues i Drejtorisë për mbrojtje sociale dhe shëndetësi, OCZP, shoqëria civile me ekspertiz. Janë nëntë anëtarë që duhet të jenë në këtë grup, dhe tani që kemi marrë këtë plan, më intereson kush janë anëtarët, emrat, sepse vërtet drejtorë, ju doni të merrni të gjitha lavdërimet, por mua më intereson emrat, kush janë ata, kush kanë marrë pjesë në këtë plan veprimi komunal. Për arsye se i shikoj këto referenca në fund, nuk e kemi firmën që e ka përfunduar, por i shikoj këto referenca dhe më pëlqejnë shumë. Nëse jeni të interesuar p.sh. për kushtetutën e Kosovës, klikoni, menjëherë do të merrni një lidhje, jeni të interesuar për një udhëzim administrativ që përdoret në zhvillimin e këtij plani veprimi, menjëherë do të merrni një lidhje. Ju merrni menjëherë atë që duhet të lexoni dhe thjesht doja t'i lavdëroja këta njerëz që kanë krijuar një Plan Veprimi të tillë.

Zeni Krasniqi: Mos t'i përsëriti edhe një herë, në mbështetje të Nenit 3 të UA 08/2018, DKA-ja e ka marrë këtë Vendim. Edhe me pëlqimin e kryetarit e kemi diskutue se është formue ky Ekip në përbërje prej nëntë anëtarëve, që e përmendi edhe Muniri, janë dy përfaqësues nga DKA, një përfaqësues i prindërve, përfaqësuesi i mësimdhënësve, kryetarja e Këshillit të nxënësve, një

drejtor shkolle, një përfaqësues nga QPS, një nga Drejtoria e Shëndetësisë, dhe nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Emrat unë mund t'i sjellë nesër, megjithëse unë e kam një vendim pak më të vjetër, se kemi bërë ndryshime, se janë ndërrue disa prej drejtorëve, mundem edhe nesër në Kuvend t'jua sjell. Kërkove që Ekipi të japë sqarime më të mëdha, nëse ka nevojë, ne gjithsesi nesër do të jemi komplet edhe me disa prej anëtarëve, sidomos me kryesuesen e këtij Ekipi, që është Alltane Tërshnjaku. Do të ju jep edhe sqarime nëse keni nevojë më shumë, megjithëse të gjitha i keni në Planin e Veprimit, po ju doni me bo pyetje, urdhëroni boni! Kush i ndan këto mjete: Ne veç i kemi propozuar, këto mjete duhet të ndahen këtu diku. Megjithëse ekzistojnë edhe këto ekipe të veprimit nëpër të gjitha shkollat. Këto në shkolla normal që nuk kërkohet kosto. Mirëpo, nëse kërkohet kosto, prej të hyrave vetanake mundin për shembull me e bo një vizitë në shkollë edhe s'besoj që duhet mjete. Mirëpo, për të gjitha këto trajnimet që i keni, për qëllimet, objektivat kryesore që i keni të shënuara në forma tabelare për secilin trajnim, ekipi e ka paraparë. Nëse ju e miratoni, mirë, nëse jo... domethënë, ekipi ka kërkuar që të ndahen këto mjete për me u funksionalizue ky ekip. Për psikologët, thashë, ka qenë kërkesë edhe e mëhershme dhe është e domosdoshme që t'i kemi. Ne për momentin nuk kemi, nuk kemi përgatit konkurse, mirëpo në të ardhmen presim që, së paku na DKA-ja ta kemi një psikolog. Unë ty veç ta dhashë përgjigjen, kërkove këtë përbërjen prej 9 anëtarësh, të thashë kush e përfaqëson këtë ekip. Sipas këtij Udhëzimi, e kemi marrë Vendimin, kemi formue Ekipin me këta përfaqësues. Ju e dini se për këto rastë të veçanta i kemi dy edukatore, një e kemi këtu në "Fetah Sylejmani", që merren me këto raste, mbajnë trajnime të ndryshme, bëhet vlerësimi i punës së tyre prej DKA-së dhe përcillen në Ministri. Kështu ndonjë hapësirë adekuate nuk kemi, por ato janë në shkollën "Fetah Sylejmani". Mandej, ti e din që e kemi formue dhe Qendrat me Bazë në Komunitet në Bresanë, me dy paralele, për këta fëmijët me edukim të hershëm. Edhe këtu e kemi me 26 anëtarë, atje e kemi me 51 fëmijë. Arijeta Skeraj: Faleminderit, drejtor! A do dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pikës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, edhe këtë pikë e kalojmë. Atëherë dalim te pika e tretë, te pika eventuale.

Artan Loshaj: Kryetar edhe ma herët të thashë, po më vjen mirë që do foto i pashë dje, që keni fillue me e ndreq stadionin. Edhe pse shumë me vonesë, me shumë harxhime të mëdha, po më në fund keni fillue me lëviz kah e mira. Kur të boni foto të suksesit, boni edhe deni foto të dështimit, s'i keni kap edhe ato rrethojat pak, që janë në gjendje jo të mirë. S'e keni bo edhe deni foto brenda në zhveshtore, ku ata fëmijët tanë besoj që në fund të gushtit që të fillojnë aty, viti 2024/2025 edhe i KF "Opojës" edhe i fëmijëve të "Aromës" edhe të FC "Dragashit". Është mirë edhe ato, ose me na kallxue qeto dështimet që janë, a do të filloni me i bo edhe kur. Po deni syret me thonë qe, stadioni u konë keq e është mirë, edhe qeto i kemi keq, janë shumë në gjendje të rëndë, po edhe këto do të fillojmë me i bo mirë. Se unë vetë prom kesh, kur i pashë ato, kesh i bona veç ja dy rreshta i kishit shtrure, sa për foto, ja dy renda të barit. S'kish pas ndonjë punë të madhe aty, besoj që sot nashta filloni po... Qat zhveshtoren, ta kam kallxue edhe herën e parë, është mjerim, s'di a ke hy deni herë, a ke pas mundësi me hy brenda me pa atje. Është mjerim, kryetar, aty. Xhamat e thyta, rrethojat, makinat po hyjnë. Është mirë me thënë që edhe dështojmë ndonjë herë. Nesër është mirë, kryesuese – si asambleist a kam të drejtë me e lyp një projektor qetu, me e vu edhe qytetarët

me i pa fotot. A mundish me ma mundësue nesër një projektor, për ja 10 minuta, për hir të qytetarëve. Se unë në Facebook s'po di me qit, rrjetet sociale i kam pak pikë të dobët kështu.

Bexhet Xheladini: Ne me FFK-në e kemi bërë një marrëveshje. Këto punët që jemi duke i bërë, ne shumë mirë e kemi sqarue. Po përgatitet fusha, nuk kemi thënë rrethoja, zhveshtoret etj. Rrethoja edhe zhveshtorja është projekt tjetër, të cilin do ta bëjë federata. Kështu që, ne e kemi pas në kontakt me e bo fushën edhe zhveshtoren, edhe ajo po bëhet. Unë atë ditë takimin që e pata me këtë turkin, atë ekspertin i cili është duke e vendos barin, tha brenda dy javëve ne fushën e përgatitim krejt. Kështu që, i mbetet federatës me bo edhe rrethojën, edhe zhveshtoren, edhe tribinat normal. Kjë është, ma merr mendja që je i kënaqur me përgjigjen. Edhe përshkrimin nëse duash merre e lexo, e kemi bërë vetëm për fushën. Nuk kemi thënë për stadionin krejt, po për fushën.

Artan Loshaj: Kryetar, shumë mirë që po bëhet të thashë. Vallahë, shumë seriozisht po të them, shyqyr që po bëhet fusha, se përnime fëmijët s'kanë ku me lujt. Sezoni u krye, tash në fund të gushtit e në fillim të shtatorit, besoj se edhe "Opoja" edhe këta bare në fushë do të luajnë. Po edhe ju si pushtet, e sidomos VV-ja, kur ishte Laurati këtu, edhe këta që janë në pushtet, 218 mijë euro janë harxhë për atë stadion në pushtetin e PDK-së. 230 mijë euro, drejtori i Financave i ka prurë që janë harxhë vitin e kaluar. 450 mijë euro edhe është stadioni mjerim, ta kam thënë edhe herë e parë, San Siro ka kushtu 500 mijë euro mendreq, renovimi. Këtu është problemi, paret janë harxhë, ku janë paret? Ju keni thënë që janë manipulue këto paret. Hajde! VV-ja na ka akuzue këtu, re hajke qaj Laurati, thojke ju e keni pushtetin, ju e keni prokurorinë. Tash edhe ju e keni prokurorinë, hajde bre vazhdoni! Ta shohim ku kanë shkue paret. 440-450 mijë euro kanë shkue, ku janë këto paret? Edhe një pyetje për znj.kryesuesë edhe për ty si kryetar i Komisionit. Pagat dhe mëditjet bre, një Komision qe një vit e keni bo, ku jemi a ku kemi mbri, a? Kryesuesë, a ka mundësi një sqarim me na dhënë, se një Komision u bo prej 7 a 8, a 10 anëtarë, PDK e krejt partitë, ku keni mbri a ka mundësi me na kallxue? Se tash mu po më thojnë poshtë shumë paret ke marrë, hala po duhet me kthye unë. E ta dimë realitetin, ta dimë të vërtetën ku jemi.

Uran Halimi: Unë deshta veç një pyetje me ia bo kryesueses. Sa i përket punës së stadionit, s'e di unë çka ka ndodhë, ju e dini ma mirë se kjo i përket legjislaturës së kalume. Kryetari ka shkue kapak edhe jau ka fshi ato gjurmët aty. Ju ka akuzue realisht LDK-ja që ka me ju padit për keqpërdorim, po masnej harroi, se i dolën do punë tjera edhe shkoi ia fshini gjurmët. Kryesuesë, unë veç një pyetje e kam në lidhje me listat e nënshkrimeve të pagave, pse na nuk i kemi ato? Nuk e dimë as sa paret marrim, a qysh marrim, veç na qitën në llogari. Nëse kishe mund me ndikue që me e nënshkrue na atë pagën që po e marrim, ose kush është t'u e nënshkrue atë. Unë s'kam nënshkrue deni herë, bon vaki qe gjashtë muaj që kam marrë pagë. Jo nuk bën kështu, unë kam punue edhe në institucion arsimor, çdo muaj unë e kam nënshkrue pagën. Nuk është në rregull kjo, me nënshkrue një herë për krejt vitin, se kemi kohë na, kemi mundësi. A mundish me ma dhënë një përgjigje, kryesuesë, edhe a mundish me ndikue që na me i nënshkrue listat e pagave çdo muaj, qysh është me rregull. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Uran! Atëherë, në qoftë se nuk ka, i pata unë dy pyetje. Pyetjen e parë për projektorin, nuk do të vjen projektori, nuk do të ketë në seancë projektor. I keni lloptopët

për atë arsye, mundish me marrë lloptopin, e ka foton e madhe, mundish me e qit, projektor nuk do të ketë, se tash e kemi vizitën studimore, masnej duket me i qit edhe fotot. E dyta pyetje e Artanit ishte për pagat. Ne e dimë që e kemi formue një Komision më herët, edhe i ka skadue afati atij Komisionit, kështu që nesër është mirë me e diskutue në Kuvend, me na raportue Komisioni deri ku ka mbri dhe çka kanë bo me pagat dhe mëditjet tona që dikujt i janë ndalë ka tre-katër muaj. Unë personalisht jam për katër muaj që kam marrë financa hiç. Ne mundim si anëtarë me e bo një komision qysh nesër, në qoftë se e lejojnë asambleistët. Pyetja tjetër nga Uran, Lista e pagave, nesër do të jenë të gjitha listat e pagave, do të nënshkruhen nga të gjithë asambleistët, dhe unë e kam bo një kërkesë që çdo muaj të vijnë listat e pagave dhe të nënshkruhen. Nesër sigurt janë për tre muaj, kanë me ardhë listat, se unë e kam bërë një kërkesë, pse nuk po nënshkruajnë anëtarët e Kuvendit, kur ligjërisht na takon çdo muaj na me nënshkrue se çka po marrim pagë.

Bexhet Xheladini: Unë nuk mund të jap përgjegjësi për pushtetin e kaluar, se çka ka bo me stadionin. E di që nuk lype përgjegjësi. Por, çka ka bo me stadionin, a ka keqpërdorë mjete a jo, unë në fushatë nuk kam thënë që do t'i paditi. Unë jam kryetar i LDK-së tash, edhe i Komunës. Unë në fushatë nuk kam thënë që do ta paditi, të merrem me padi për stadionin. Unë po flas për vete. Edhe tash, a ka pas keqpërdorime a jo, prokuroria këtë e din, edhe me sa e di unë i pat fillue në atë kohë disa hetime. Por megjithatë, ne s'kemi mujt me e lënë stadionin tash, me e prit prokurorinë deri ta bjer vendimin edhe të vendosë se çka është puna. Ne jemi munduar atë stadion me e rregullue. Dhe besoj që do ta rregullojmë ashtu qysh kam premtue. Unë nuk ta përmenda emrin, ti mujsh me dalë me diskutue, mirëpo unë nuk do të merrem me padi. Ata të cilët kanë argumente, munden me e çue lëndën në prokurori. Përndryshe, ne do të punojmë, nuk do të kqyrim mbrapa, veç do të kqyrim përpara.

Munir Jonuzi: Ljamerohem në lidhje me këtë komision, i cili do të shqyrtonte pagat dhe mëditjet e delegatëve të këtij Kuvendi. Pak më parë kam dëgjuar që ju keni thënë se i ka kaluar mandati këtij komisioni. Ky komision ende funksionon, edhe pse nuk jemi takuar në gjashtë muajt e fundit, duhet të ulemi sërish dhe të përfundojmë raportin përfundimtar. Deri më tani, ajo që kemi vërejtur është se në listën e pagave është një person, mbiemri i të cilit nuk ekziston në këtë kuvend dhe ka dy vite e gjysmë që merr pagë.

Artan Loshaj: z.Kryetar, në 2021-tën ti ke qenë kandidat për kryetar të Komunës. Nuk ke qenë kryetar i partisë të LDK-së. Unë po them, LDK-ja me kandidatin e juaj që keni pas kryetar, është akuzue, nëpër media e ke – neër unë kam me e marrë në lloptop edhe kam me e qit qetu – që kanë thënë keqpërdorim në shëndetësi, keqpërdorim në financa, keqpërdorim në urbanizëm. Domethënë, me qeto afera ju keni ardhë në pushtet. Tash po thoni nuk po i paditim, keni thënë që do t'i padisim. Edhe unë s'thashë ka keqpërdorime, unë kam dyshue në keqpërdorime, se s'ke qenë ti atëherë ti këtu prezent, kqyri fjalimet e mia. Unë kam thënë 218 mijë euro që ne i kemi ndarë, edhe Arijeta edhe këta tjerit që kemi qenë këtu, ku janë këto mjetet. 230 mijë euro i keni ndarë ju, unë po dyshoj që me 450 mijë euro është dashtë me u krye stadioni moti, m'u harrue, m'u bo renovimi i stadionit. Jo hala me u marrë me rrethojat e me u marrë me ato sendet. Tash je kryetar i LDK-së edhe kryetar i Komunës. Une nuk po të foli për ma 2021-tës, unë po të foli para se me e marrë pushtetin. Edhe keni thënë, si parti, si LDK, që keqpërdorimet – prapë po ta përsëriti –

keqpërdorimet në shëndetësi, keqpërdorimet në urbanizëm, aty vetvetiu të shtish me dyshue që kur të thuesh keqpërdorim, ka korrupsion aty. Edhe unë kam thënë, edhe pse është PDK-ja, se jem konë asambleistë i PDK-së, unë gjithmonë kam qenë qeky Artani, bile kam qenë më i ashpër me PDK-në se me ju. Unë jam përfaqësues i qytetarëve, unë kam marrë vota prej Restelicës e në Zaplluxhe. Edhe unë ma pak jam t'u hesht me ju, se me PDK-në. Këtu është problemi. "Unë s'kam thënë" – keni thënë, LDK-ja ka thënë që ka dyshime, do t'i padisim. Një herë më thaje kanë fillue disa hetime, tash po thuesh unë s'i çoj, këtu është një mjegull. Vetë thaje qetu, kanë fillue, tash po thuesh unë s'i çoj. E pse s'po i çojsh? Po na shtish me dyshue neve se qata njerëz që kanë punue në Komunë me PDK-në, qata po punojnë me ju. Qata mbikëqyrësa, qata tenderues, qata janë o kryetar. Ta kam thënë edhe në fillim, po gutesh kryetar, je t'u u gut se 14 vjet nuk keni qenë në pushtet. I ke çue në qiell, ata 14 vjet kanë punue me ne, me qata ke me punue. Je bo ma i mirë me ata të PDK-së se që je me të LDK-së. Pse? Se interesi. Unë po dyshoj që, në qoftë se thuesh kanë pas hetimet me vazhdue, edhe tash nuk po vazhdojnë edhe ti nuk po i çojsh, po më shti me dyshue që dish diçka e s'po i çojsh ti.

Uran Halimi: Sa i përket Komisionit të pagave, unë kam qenë edhe kryetar i atij Komisioni. Janë mbajtur disa takime, puna nuk është përfundue. Mandat kemi, se na kemi me e hetue një periudhë të pagave, një pjesë kohore, deri në momentin kur ne raportojmë, kemi mandate për me raportue edhe hetue. Na mundim me i vazhdue punimet, nesër mundim me u takue me krejt anëtarët e Komisionit, nashta edhe mas seancës, ose me e lënë një takim të veçantë edhe me e përmbyllë punën. Sa i përket atyre gjetjeve, do të raportojmë edhe në lidhje me pretendimin e z.Jonuzi edhe të gjithë delegatëve që kanë ngrit shqetësime në lidhje me pagat. Po rikthehem te stadiumi, që e përmendi z.Loshaj. Sa i përket punës së stadionit, nëse ju kujtohet, jam konë ulur këtu në ulësen e kryesuesit, unë veç një pyetje e kam bo kur është diskutue për stadiumin e Dragashit. Kam thënë, po më intereson a është i njëjti mbikëqyrës i punimeve, sikur ai i mëhershmi. Se u diskutue që ka pas keqpërdorime më herët. Unë vetëm një pyetje e kam bo, kam thënë a është i njëjti mbikëqyrës, sikur më herët, edhe tash. Më janë përgjigj që po, është i njëjti mbikëqyrës i punimeve, ose të njëjtit mbikëqyrës, kushdo qoftë aty. Edhe aty e kam marrë përgjigjen se çfarë punime kanë me u bo te ky stadiumi. Realisht, nuk pres diçka më mirë sesa akuzat që i ka bo LDK-ja në këtë drejtim. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Nashta nuk është mirë që po dal shumë herë këtu, por nuk bën me bo mjegullina, në mënyrë që njerëzit me e kuptue se vërtet ka diçka. Këtu s'ka kurgjo. Ata të cilët dyshojnë që ne nuk do ta kryejmë punën e stadionit në bazë të kontratës edhe në bazë të projektit, e formojnë një Komision, shkojnë në fund e vërtetojnë. Ne përgjigjemi për punën tonë, e jo për punën e pushtetit të kaluar. Edhe një herë po të them, unë asnjëherë nuk kam thënë që do t'i padis. Nëse unë kam thënë që ka pas keqpërdorime edhe nuk janë krye punët ashtu si duhet, në bazë të projektit, unë e kam thënë atë haptas, para televizioneve, prokuroria ka mund me dëgjue, me thirrë, me më pyet edhe me i fillue ose me i vazhdue hetimet. Kështu që, unë përgjigjem vetëm për punët tona, e jo për punët e pushtetit të kaluar. Për ato le të merret prokuroria. Për punët tona, kur të doni ju, formojeni një Komision këtu në Kuvend – keni formue edhe më herët komisione, e dini qysh shkon – kur të përfundojnë punimet në stadion, shkoni. Edhe, sa i përket mbikëqyrësit të punimeve, nuk

e di kush ka qenë herën e kaluar, nuk e di, por tash është Sabahat Hasani. Unë nuk e di. Po ne i kemi tre inxhinierë, ja do të bëhet njëri, ja tjetri, ja tjetri. Unë nuk e di kush ka qenë, edhe për atë është komisioni, sikur komisionin që e keni bo për pagat, e boni një komision edhe për stadionin, shkon edhe e vërteton. Për tash, për të kalumin s'ke çka bësh komision. Jo, ne s'po themi na falni. Është detyrë e këtij Kuvendi me formue çfarëdo komisioni që ju mendoni se duhet me e bo. Por, unë përgjigjem për punët e pushtetit, prej kur jam kryetar. Ata tjerit përgjigjen për punët e veta. Po s'mundem unë me i amnistue, me i amnistue munden kryetarja e shtetit, ka të drejtë me amnestue të burgosur. Kryetarja e shtetit i ka disa kompetenca, prokuroria ka kompetenca, gjylata. Unë si kryetar i Komunës s'muj me e amnistue kërkond. Tash, ti mujsh me fol çka të duash, po duhet me e ditë edhe çka po fol.

Uran Halimi: Sidomos ditët e para, e muajt e parë kur kam qenë kryesues, jam mundue me qenë shumë i kthjellët edhe gjithçka e kam mbajt në mend edhe e ma në mend se çka ka ndodhë. Goxha eufori keni pas kur erdhët këtu, me do gjetje, t'u i akuzue këta, e kërcënue në njëfarë mënyre, keni me pa në vazhdim çka ka me ndodhë. Unë pritsha çka po ndodh në vazhdim, se kam pas qef edhe unë ju me shkue me padit ju si ish-qeverisje, sinqerisht po ta them, kam prit që vërtet këta drejtorët bashkë me kryetarin kanë me nxjerrë goxha telashe, të gjetura për ato të bëmat e mëhershme. E pashë që iu shishmue goxha pushteti edhe ia nisën me u marrë me të ardhmen, e jo me të kaluarën, e harruan të kaluarën krejt. Amnestim i bjer – kryetar – heqja dorë nga menaxhimi edhe nga keqpërdorimet e parasë publike të qytetarëve. Domethënë, është keqpërdorë në të kaluarën, ti e ke për obligim me e hetue atë keqpërdorim edhe qato pare që janë keqpërdorë me ua kthye qytetarëve me një mënyrë ose me një tjetër. I ke instancat, i ke pas gjykatat edhe më herët. Atë entuziazëm unë e kam pas, se na kur bëmë koalicion – kryetar – goxha kam qenë edhe unë entuziast, për qato të kam mbështet. U thojshna hajduta na këtyre, e qetash vonë po del që ku ka pas hajni. Asnjë hajdullëk s'doli në shesh, kryetar. Na bashkë e kemi bo fushatën, këta hajdutat – më falni që po ju them hajduta, se s'po del që jeni konë hajduta sipas kësaj qeverisje. Na kemi pas shumë entuziazëm, qeta hajdutat me i padit, e me i gjykue, e me jau kthye ato keqpërdorimet qytetarëve. Kjo nuk është në rregull! Me njëfarë mënyre, moshulumtimi i atyre keqpërdorimeve dhe mosraportimi në instancat më lartë, i bjer që ato hajnitë i ke amnestue edhe i ke falë, edhe po të intereson qetash do tjera me i bo. Faleminderit!

Artan Loshaj: z.Kryetar, në qoftë se e formojmë një komision – qysh po thu ti – ai komision formohet për hulumtimet e punimeve të stadiumit të qytetit të Dragashit. Kur të fillon hulumtimi, fillon prej ditës së parë, nuk fillon prej LDK-ja kur ka ardhë në pushtet. Fillon prej ditës së parë. Në qoftë se fillon prej ditës së parë, ju keni marrë mandate, edhe me të gjitha të mirat dhe të këqijat që i ka lënë pushteti, ju e keni pranue këtë pushtet. A e keni pranue për të mirën e qytetarëve, a qysh po thotë Urani, e keni pranue pak edhe ju – jo ti, por ata të tutë përreth – pak me ia ngjit në të djathë e në të majtë. Në qoftë se e ke pranue, e ke pranue me këto kushte. Unë në qoftë se e kam pranue qat grue që e kam në shpi, me të metat edhe të mirat e të këqijat, qato ia kam pranue edhe e kam bo grue edhe e vazhdoj me to. Ti po ia pranosh veç të mirat, ato të këqijat valla unë jo. Jo jo, kur ke ardhë kryetar, je betue para qytetarëve të Komunës së Dragashit që unë do të bashkëpunoj, që unë do t'i kqyri keqpërdorimet, që unë do t'i ndali keqpërdorimet. Ti vazhdosh

me të njëjtin avaz si PDK-ja, si partia jeme. Ju, publikisht – unë të kallxoj edhe me emër, po nesër të thashë, projektor kam lyp – publikisht na keni akuzue edhe për vjedhje votash, edhe nëpër gjykata na keni çue. Sot me njerëzit e PDK-së që i keni akuzue për vjedhje votash, je mjaltë e tlyen. Në 2017-tën, Makelele, ato i keni harrue. Me qata të VAKAT-it, me qato Makeleleja që kemi ardhë në pushtet, ju sot udhëhiqni. O thuj jemi konë të etur për 14 vite për pushtet, ka qenë fushatë zgjedhore, i kemi mbyllë sytë, po vazhdojmë me të njëjtit qytetarë të cilët kanë punue me PDK-në, me të njëjtit qytetarë, me të njëjtit je t'u punue edhe qetash. M'u bo pak më realista, po thuj, u konë eufori, u konë fushatë zgjedhore, kemi shkruie kush ka desht, kemi shkruie çka kemi desht, valla bre kishna gabue, se falja është gjysa...falet kur kërkosh falje. Të njëjtit i ke, unë të thashë nesër kam me t'i qit, akuzohet Hasan Hyseni, për vjedhje votash, për nënshkrim të atij, këtij, këtij. Me ata sot dita e nata nuk të ndanë. Me të VAKAT-it, edhe VATAN a qysh po iu thojnë, i ke akuzue, qet Bean Haxhisinin e ke akuzue me Ballxhin o ka vjedh vota, nesër kam me t'i qit, me Beanin e ke sot mjaltë e tlyen. Kjo është problem, pse nuk i pranoni? Vetë po thuesh formone komisionin. Kur të formohet komisioni, formohet prej ditës së parë. O burra, thuj, line se edhe një vjet më ka mbet mandat, shkoj në shpi, mandatin tjetër s'besoj që kandidoj edhe s'besoj që e fitoj, më lini rahat. Ti vetë po i japish autogollë vetvetes.

Munir Jonuzi: Sa i përket formimit të komisionit, ne si delegatë kemi të drejtë të formojmë një komision, jo vetëm për një projekt, por të formojmë një komision që do të përfshijë të gjitha projektet që kryhen në komunën tonë. Në kuptimin që ne mbikëqyrim mënyrën e zbatimit të tyre dhe se komisioni është nën kujdesin e pushtetit ekzekutiv ose nën kujdesin e kuvendit komunal. Mirëpo edhe ne si komision për politikë dhe financa mund të kemi obligim të shikojmë se si po punohet në terren, ne quhemi komisioni i financave dhe kjo financohet nga buxheti i kësaj komune, nga buxheti. të qytetarëve të këtij vendi. Ne mund ta shfrytëzojmë këtë komision dhe të kryejmë vetë monitorimin e investimeve kapitale, kështu që jo vetëm pushteti ekzekutiv do të jetë përgjegjës, por edhe ne do të marrim një pjesë të përgjegjësisë për realizimin e investimeve kapitale.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Munir! A do dikush tjetër? Në qoftë se nuk ka, e mbyllim këtë mbledhje!

**Kryesuesja e KPF-se
Arijeta Skeraj**